



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL , TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 61 prot.

Vau Dejës, më 08.09.2021

PROJEKT V E N D I M

Nr. 8 , datë 08.09.2021

PËR MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATËS SE SUBJEKTIT “ SHOQËRIA
“ALBTELECOM” SH.A PËR ANTENËN E TRANSMETIMIT TË TELEFONISE
CELULARE.

Me propozim të Kryetarit së Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e/1”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore neni 25 pika 1 e ligjit nr. 57/2020 date 30.04.2020 “Për Pyjet ”, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” i propozojme Këshillit të Bashkise Vau-Dejës, të

V E N D O S I

- 1.Miratimin e rinovimit të kontratës së subjektit “ALBtelekom Sh.a ” për antenë të telefonise celulare në ngastrën nr .15b, ekonomia pyjore Bushat Berdicë me sipërfaqe 0.03 ha si dhe rrugë kalimi me gjatësi 0.311 km.
- 2.Efektet: Jep impaktë pozitive tek subjekti/komuniteti duke rigjeneruar të ardhura , sigurohen të ardhura tek Bashkia, të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
- 3.Afati i dhënies me qira të jetë 5 vjet.
- 4.Vlera e dhënies me qira të jetë sipas studimit tekniko-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM, Nr. 1064, dt. 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

Konceptoi:M.Suli

Konceptoi Bazën Ligjore K.Shtatri

Miratoi:Rr.Ftoni

KRYETARI

MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT KULTURES DHE MJEDISIT

Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 61 prot.

Vau Dejës, më 08.09.2021

RELACION

PËR MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATËS SE SUBJEKTIT “ SHOQËRIA “ALBTELECOM” SH.A PËR ANTENËN E TRANSMETIMIT TË TELEFONISË CELULARE.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia **Vau i Dejës**, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilët është edhe administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ka në administrimin e saj gjithsej 31 118.2 ha ha. Pjesë e këtij administrimi është edhe dhënia me qera/përdorim e këtij fondi pyjor nëpërmjet të tretëve.

Për antenën e komunikimit të telefonisë celulare **ALBtelecom** e ndodhur në Zefjane, Njësia Administrative Bushat, me **nr. 1003** e lidhur nga Bashkia Vau Dejës me datën 30.04.2020, sipa vendimit të Këshillit Bashkiak ka përfunduar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar pranë Bashkisë Vau i Dejës/ Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave , rezulton që parcela në të cilën është e ndërtuar kjo antenë komunikimi , është pjesë e inventarit të pronave të Bashkisë Vau i Dejës , kjo bazuar në në VKM nr. 433 dt 08.06.2016 i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive”, me nr Ngastre 15b dhe bën pjesë në ekonomine pyjore **Bushat Bërdice**, sipas listes së inventarit, **shtojca nr.47** me numër rendor **18**.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , neni 27 pika 5, neni 54 pika e1 , është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , tjetërsimi apo dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror

publik”, pika 22/g , përjashton nga konkurimi publik dhënien në përdorim të sipërfaqeve për ndertimin e antenave të komunikimit radiotelevizive dhe telefonisë celulare.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria **ALBtelecom**” sha është konform pikës 22 g të këtij Udhëzimi,pikës 24 dhe përbëhet nga:

- a) leja/licenca përkatëse nga institucioni qendror për ushtrimin e veprimtarisë;
- b) kontratat ekzistuese të lidhura me autoritetet përkatëse ,Bashkia Vau Dejës
- c) projektin teknik të zbatimit
- d) hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në formatin PDF dhe në format elektronik në shkallën 1:10 000 ku janë evidentuar elementet kryesore, si: zona kadastrale sipas ZRPP-së, kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, si dhe lidhjen me të dhënat për treguesit kadastralë pyjorë dhe kullosorë;
- e) lejen e mjedisit
- f) lejen e ndërtimit;
- g) aktin e regjistrimit pranë QKR-së.

Bazuar në ligjin nr 57/20 dt 30.04.2020 “Për pyjet neni 25 , VKM nr. 1064 date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391/2006 “ Për tarifatat në shërbimin pyjor/kullosor i ndryshuar , lidhja 2 pikat 7,12 në bazë të “përdorimit të territorit” dhe afatit të dhënies në përdorim janë përcaktuar tarifatat si më poshtë:

7. Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizëshme, televizive, radio-komunikimit				
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqia e perdorur ne ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit	
			1-5 vjet	6-10 vjet
1	Toke me Bimësi Pyjore	0.03	6 500 000	5 500 000

Ne funksion te sipërfaqes që merret në përdorim,subjekti ka servitut edhe përdorimin e Linjës së Tensionit elektrik dhe rrugën,Bushat -Zefjane ,të cilat sipas VKM 1064,Lidhja 2,Pikat 11;12 ,Tarifohen si më poshte:

12. Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues			
Nr.	Përdorimi i territorit	Siperfaqia e përdorur në km	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/km/vit
1	Toke me Bimësi Pyjore	0.311	30 000

Ne total 204330 lekë

Nga ana e Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave është përgatitur Raport Studimi Tekniko Ekonomik për këto sipërfaqe si edhe tabelat shoqëruese sipas modelit të miratuar në Udhëzimin nr 1 të Ministrit të Mjedisit, me të dhënat kryesore të sipërfaqes objekt përdorimi , hartat topografike me koordinatat , kufijtë si edhe përdorimin e territorit.

Bazuar në sa më sipër propozojmë rinovimin e kontratës për dhënie në përdorim me qera për një afat **5(pesë) vjekar**,për shfrytëzimin e sipërfaqes me **Bimësi Pyjore** sipas të dhënave të sipërcituara.

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit

Ing. Mark Suli



Specialistet

Ing. Esmeraldo Harapi



Miratoi

Drejtori

Rrok ftoni



Ing. Zeqir Ujka



R A P O R T

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS

RINOVIM KONTRATË SUBJEKTIT "ALBTELECOM" Sh.A, STACIONI 1003 BUSHAT PËR ANTENËS TË TELEFONISE CELULARE.

Bazuar në Urdhërin nr.55 datë 11.02.2021 të kryetarit të bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore objekt, *rinovim kontrate subjektit "albtelecom" sh.a, stacioni 1003 bushat për antenë të telefonise celulare*, grupi i punës i përbërë nga, **Z.Zeqir Ujka dhe Z.Mark Suli,Esmeraldo Harapi**, të cilët nga data **06.09.2021** deri në datën **07.09.2021**, realizuan verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore objekt i dhënies në përdorim për Antenë të telefonisë celulare.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullor sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016,i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive, rezulton që sipërfaqja e kërkuar është 0.03 ha, dhe bën pjese në **ngastrën nr.15b** në ekonomine pyjore **Bushat Bërdice**,sipas listes së inventarit, **shtojca nr.47** me numër rendor **18** dhe është në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohen në tabelën 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse 1 dhe 2 Bashkelidhur).*

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga **Shoqëria "ALBtelecom" Sh.a**, nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve, në ngastrën **nr.15b,ekonominë Pyjore Bushat Bërdice**, por jepen në përdorim në një afat **5 vjeçar**.

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim nga fondi pyjor dhe kullor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar.

"Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor", në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 9.06.2016 "Për rregullat ,procedurat e

kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”,pika 22 germa g.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë **Vau Dejës** dhe likujdimin të tarifës prej **204330 (Dyqind e kater mije treqind e tridhjte) lekë**.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-ve në 1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”,si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. Shuma në lekë/vit konsiston në:

a/1) Vlerën e përdorimit lek/ha/vit

Trungishte _____ ha x _____ lek = _____ lekë

Cungishte _____ ha x _____ lek = _____ lekë

Shkurre _____ ha x _____ lek = _____ lekë

Toke me bimësi pyjore... ha 0.03 x 6 500 000 leke/ha/vit = **195 000** lekë

a/2) Vlera e përdorimit të rrugës auto në km

Trungishte _____ km x _____ lek = _____ lekë

Cungishte _____ km x _____ lek = _____ lekë

Shkurre _____ km x _____ lek = _____ lekë

Toke me bimësi pyjore..0.311 km rruge auoto x 30 000 leke/km/vit = **9330** lekë

Total Vlera 204330 (Dyqind e kater mije treqind e tridhjte) lekë

Ing.Zeqir Ujka



Ing.Mark Suli



Esmeraldo Harapi



KRYETARI

MARK BABANI



Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas regjistrit kadastral)

Per antene celulare bushat

ID.	Ekon.Pyjore	Parc	Perb.	Funksioni	Forma Qeverisj es	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
								D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Katet	per ha	Total
Sh160015b	Bushat Berdice	15b	bimsi pyjore		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsejt	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas verifikimit ne terren)

Formulari 1

Per antene celulare

ID.	Ekon.Pyjore	Parc	Perb.	Funksioni	Forma Qeverisj es	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
								D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Katet	per ha	Total
Sh160015b	Bushat Berdice	15b	bimsi pyjore		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsejt	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali														

PLOTESOI:

Ing. Zeqir Ujka



Ing. Mark Suli



Esmeraldo Harapi



Bashkia Vau Dejës

TABELA PERMBLEDHËSE E VLËRESIMIT FINANCIAR

Perdorimi I territorit	Sip ha	Bashkia	Volumi ne m ³ sipas asortimenteve	Dhenje ne perdorim lek/ha/vit		Vlera lek m ³	Shuma I	Gjatesia e perdorimit ne km	Tarifa dhenje ne perdorim lek/km/vit			Shuma II	Totali I+II	
				Ha	leke				1	6.-10				
										2.-5	6.-10			
0	1	0 Vau Dejës	3			4	5	6	7	8	9	10	11	12
Trungishte	0	Vau Dejës	L. punimi	0	0	0	0	0	Rruge	0	0	0	0	0
			Dru zjarri	0	0	0	0	0	Linje	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	Tubac	0	0	0	0	0
Cungishte	0			0	0	0	0	0	Rruge	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	Linje	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	Tubac	0	0	0	0	0
Shkurre	0			0	0	0	0	0	Rruge	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	Linje	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	Tubac	0	0	0	0	0
Kullote	0	Vau Dejës		0	0	0	0	0	Rruge	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	Linje	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	Tubac	0	0	0	0	0
Bimsi pyjore djerr	0.03	Vau Dejës		0	0	0	0	0.311	Rruge	9330	0	0	9330	9330
				0	0.03	195 000	0	0		0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	Tubac	0	0	0	0	0
Inprodukti ve	0	Vau Dejës		0	0	0	0	0	Rruge	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	Linje	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	Tubac	0	0	0	0	0
Bime med	0			0	0	0	0	0		0	0	0	0	0
Gjuetia	0		Lepur, Thell.	0	0	0	0	0		0	0	0	0	0
Invest	0	Vau Dejës		0	0	0	0	0		0	0	0	0	0
Gjithsejt							0	0.03	195 000	0	0	0	195 000	204 330

PLOTESOI:


Ing. Zeqir Ujka

Ing. Mark Suli

Esmeraldo Harapi

Subjekti "Albtelecom "Sh.a
Ekonomia Pyjore Bushat Berdise
Ngastar nr 15 b

Antene interneti



Antene interneti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
Nr. 2296 prot.

Vau Dejës, më 30.04.2020

ALB TELEKOM Sh.a.
Nr. 2750 prot.

Tiranë, më 30.04.2020

KONTRATE QIRAJE

PER

DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR

Në zbatim të nenit 19 të ligjit Nr. 9385 datë 04.05.2005 “ *Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor*”, të ndryshuar, nenit 17 të ligjit Nr.9693, datë 19.03.2007 “*Për fondin Kullosor* të ndryshuar, nenit 801 e në vijim të ligjit Nr.7850, date 29.07.1994, “*Per Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, Vendimin nr. 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “*Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve”* dhe Vendimit të Keshillit të Bashkise Vau Dejës nr. 06, date 24.01.2020, “*Për miratimin e rinovimit të kontratës për dhenien me qira të fondit pyjor për antene të telefonisë celulare subjektit “ Albtelecom”*”, lidhet kjo kontratë qiraje ndërmjet palëve:

I. PALET :

Bashkia Vau Dejës, e përfaqësuar me autorizim nga zv. Kryetar **Z. Kristian Shkreli** që këtu e më poshtë do të quhet “**Qiradhënësi**”: dhe

Alb Telekom Sh.A. (këtu e më poshtë referuar si “**AlbTelekom** ” ose “**Qiramarrësi**”) regjistruar si person fizik me Vendimin nr. 20820, datë 16.02.1999, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me adrese Rruga Autostrada Tirane Durres, km 7, Kashar, Tirane, Shqipëri, përfaqësuar me prokurë me nr. 448 Rep ,me nr 78/3 Kol date 22.01.2020 nga z.**Henri Tabaku** , mbajtës i leternjoftimit nr. I70101099U, me zotësi të plotë juridike për të vepruar; **Z. Ufuk Çelik** , mbajtës i leternjoftimit U07618668, shtetas turk me zotësi të plotë për të vepruar.

Qiradhënësi dhe **AlbTelekom sh.a/Qiramarrësi** më poshtë do të quhen individualisht si “Pala” ose së bashku ”Palët”.

II. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Duke qenë se ekzistojnë kushtet paraprake, të cilat përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate, Palët bien dakord si vijon:

1. Kushtet Paraprake dhe Shtojcat.

Kushtet Paraprake ashtu si dhe Shtojcat përbëjnë pjesë integrale të saj.

2. Përcaktime.

Sipërfaqe përdorimi: Vendi në të cilën do të ushtrohet veprimtaria për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të saj, të miratuar. **Stacioni 1003 Bushat.**

Rrugë Kalimi/E Drejta e Kalimit: Rruga nga rruga kryesore për të hyrë në sipërfaqen e marrë në përdorim aktualisht është pjesë e fondit pyjor/kullosor kombëtar, e administruar nga qiradhënësi, dhe do të shërbejë subjektit.

Neni 1

Objekti i kontratës

- 1.1** Objekti i kësaj kontrate është, **dhenia me qira te 0.03 (ha)**(bimesi pyjore) e përfshirë në ekomominë pyjore Bushat Berdice, **ngastra nr. 13** në pronësi të Bashkise Vau Dejes, shoqërisë **“Alb Telecom” sh.a**, për ushtrimin e veprimtarisë së telefonise celulare, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Bashkise Vau Dejes nr. **06, date 24.01.2020**, *“Për miratimin e rinovimit të kontratës për dhenien me qira të fondit pyjor për antene të telefonisë celulare subjektit “ Albtelecom”, me kufizimet dhe kordinatat sipas hartës pyjore ku është pasqyruar vendosja e antenës rrugës auto, të dhënë në Aneksin C.*
- 1.2** Qiradhënësi i jep gjithashtu subjektit AlbTelecom, në përputhje me Vendimin të Këshillit të Bashkise Vau Dejes nr. **06, date 24.01.2020**, *“Për miratimin e rinovimit të kontratës për dhenien me qira të fondit pyjor për antene të telefonisë celulare subjektit “ Albtelecom”, “për përdorim të 0.311 km për rrugë kalimi, për të bërë të mundëshme kalimin nga rruga kryesore për në sipërfaqen e marrë në përdorim për periudhën 1 (nje) vite. Venddodhja e sipërfaqes së dhënë në përdorim dhe rruga kryesore tregohen në hartën pyjore ku është pasqyruar vendosja e antenes linjës dhe rrugët ndihmëse, të dhëna në Aneksin C.*

Neni 2

Qëllimi

Kjo Kontratë ka për qëllim dhënien në përdorim të sipërfaqes të përcaktuar në Nenin 1 të kësaj kontrate për ushtrimin e veprimtarisë: **“antene e telefonise celulare”**, vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes të miratuar nga Ministri për ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë dhe në Lejen Mjedisore.

Neni 3

Afati i kontratës

Kontrata e Qerasë fillon efektet nga data 22.01.2020 deri me datën 20.01.2021.

Neni 4

Vlera e kontratës

-Vlera e kontrates do te jete për periudhën 22.01.2020 deri me datën 20.01.2021 me vlere 204,330 (dyqind e katermije treqind e tridhjetë) lekë sipas zerave më poshtë”:

-Vlera e qerasë vjetore,

-Për vendosje të stacionit të antënës me aksesorët e përdorimit, për tokën me bimësi pyjore është **0.03 ha x 650,000 leke/ha = 195,000 lekë.**

-Për përdorim të fondit pyjor e rrugës lidhese me sipërfaqen në përdorim, për tokën me bimësi pyjore është **0,311 km x 30,000 leke/km = 9,330 lekë.**

Njësia Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës

✓ **Total: 204,330 (dyqind e katermije treqind e tridhjetë) lekë**

e llogaritur sipas VKM 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve” .

Njësia Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës

Vlera e linjës elektrike , paguhet vetem një herë.

Gjithsej : vlera e kontratës është 204,330 (dyqind e katermije treqind e tridhjetë) lekë

Neni 5


Pagesa dhe regjimi i saj

- 5.1 Pagesa e qerasë do të bëhet sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- 5.2 Pagesa e periudhës 12.02.2020 deri me 12.02.2021 do të bëhet brënda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i Kontratës nga Palët dhe pas lëshimit të fatures për arkëtim nga qiradhënësi.
- 5.3 Vlera e qerasë është e pandryshueshme. Ajo do të ndryshojë vetëm nëse do të ketë ndryshime të aktit nënligjor VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, të ndryshuar me V.K.M. 1064 datë 22.12.2010.
- 5.4 Qiraja do paguhet në llogarinë bankare të Bashkisë Vau Dejës, sipas faturës për arkëtim.
- 5.5 Në rast se Qeramarrësi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura sa me sipër, Qiradhënësi përfiton një kamatë vonesë prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10 % e vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes së kamatë vonesave do të konsiderohet data e përcaktuar në pikën 5.2 dhe 5.3 të kësaj kontrate.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit


- 6.1 Qiradhënësi merr përsipër dhe i krijon qiramarrësit mundesine që ta gëzojë dhe ta përdorë atë qetësisht ndaj pretendimeve të pabazuara ligjërisht të ngritura nga të tretët.



- 6.2 Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që, nuk kanë të bëjnë sipërfaqen e dhënë në përdorim, me objektin dhe qëllimin e kontratës.
- 6.3 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ato të përcaktuara në planin e rehabilitimit dhe kushtet e Lejes Mjedisore si dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.
- 6.4 Qiradhënësi miraton planin e rehabilitimit të mjedisit pyjor objekt përdorimi, monitoron dhe merr në dorezim sipërfaqen pas rehabilitimit.

Neni 7 Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

- 7.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate "Qiramarrësi" ka të drejtë që për të punësuarit e tij, agjentë, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që Qiramarrësi i konsideron të përshtatshëm, të ketë të drejtën të hyjë lirisht në pronën objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; të transportojë mallra paisje dhe materiale të tjera brenda sipërfaqes të marrë me qira; të bëjë ndërtime të përkohëshme ose të përhershme, si dhe punime të tjera në përputhje me kërkesat e planit të rehabilitimit të sipërfaqes objekt përdorimi dhe kushteve të Lejes Mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të saj.
- 7.2 Qiramarrësi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e sipërfaqes së marrë në përdorim, të tretëve, pa marrë më parë miratimin nga Qiradhënësi për ushtrimin e veprimtarisë.
- 7.3 Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me qira dhe të lidhë nënkontraktime me subjekte të tjerë apo t'ja kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.
- 7.4 Qiramarrësi, do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do të konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marrë në përdorim dhe në Rrugën e Kalimit.
- 7.5 Qiramarrësi do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim dhe Rrugën e Kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin që përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të kësaj kontrate.
- 7.6 Qiramarrësi të mbrojë dhe mirë administrojë sipërfaqen pyjore/kullosore në përputhje me dispozitat e Ligjit 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar dhe të Ligjit 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar.
- 7.7 Qiramarrësi të lejojë dhe të shoqërojë punonjësit e Bashkisë të ushtrorin kontrollë për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor të dhënë në përdorim.
- 7.8 Qiramarrësi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë ligjore që del e re ose ndryshim që u bëhet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.
- 7.9 Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mësipërme të kontratës, zbatohen kërkesat e neneve 37 dhe 38 të ligjit 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar.
- 7.10 Harton dhe miraton në Bashkinë Vau Dejes planin e reabilitimit dhe ndjek zbatimin e tij.
- 7.11 Rehabilitimi do realizohet brenda 30 diteve nga momenti i zgjidhjes së kontratës, ose në rast se palët vendosin që të mos e rinovojnë kontratën. Gjithashtu pajisjet do hiqen brenda 30 diteve nga zgjidhja e kontratës, ose në rast se nuk rinovohet kontrata.



- 7.12 Qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës në rast se nuk merr dot leje miratimi, aprovim nga pushteti dhe /ose agjensitë lokale dhe nuk nënshkruan ndonjë nga dokumentet në lidhje me këtë kontratë.
- 7.13 Qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës në rast se është i detyruar të largohet nga territori i i Republikës së Shqipërisë për shkak të luftës, trazirave apo të ndonjë arsye të tillë.
- 7.14 Qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës në rast se nuk mund të gëzojë qetësisht pronën e marrë me qira.
- 7.15 Një përfundim i tillë i kontratës është i nevojshëm për performancën e aktivitetit të tij.
- 7.16 Shenim: Në të gjitha rastet qiradhënësi duhet të lajmëroje paraprakisht 30 dite para për zgjidhjen e kontratës, si dhe të realizojë planin e rehabilitimit.

Neni 8 **Detyrime të përbashkëta të palëve**

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim në adresat e më poshme:

Për Qiradhënësin: Bashkia Vau Dejës
Për Qiramarrësin: Alb Telecom, sh.a
Tel kontakti 0672001245.

Neni 9 **Forca madhore**

Në rast se ndonjë nga Palët e kësaj Kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Kontratë si pasojë e Forcës Madhore, kjo Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga Forca Madhore. Pëzullimi i ekzekutimit të kësaj Kontrate si pasojë e Forcës Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Madhore.

Neni 10 **Zgjidhja e kontratës**

- 10.1 Kjo kontratë përfundon në momentin e përfundimit të afatit të saj të përcaktuar në nenin 3.
- 10.2 Kjo kontratë është automatikisht e pavlefshme, nëse nuk është nënshkruar pasi të jetë marrë miratimi nga (Këshilli i Bashkisë), sipas kërkesave të Nenit 17 të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullor", të ndryshuar dhe nenit 19 të ligjit Nr. 9385 datë 04.05.2005 " Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", të ndryshuar, si dhe kur kontrata është e pashoqëruar me Vendimin nr. 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve" **lidhja 2 pika 7** , lidhja 2, Pika 12 ,harten pyjore te gjereferuar me poligonin e ndertimit(gjurmen e ndertimit) koordinatat përkatëse, si dhe të firmosura dhe vulosura nga Bashkia Vau Dejes.
- 10.3 Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj, për shkak të ndryshimit dhe mosrespektimit të kushteve kontraktore, të moskryerjes së pagesës së qirasë në afatin e caktuar, të

mosrespektimit te kushteve të lejes mjedisore, si dhe per shkaqe te tjera qe ne kuptim te ligjit konsiderohen si thelbesore per marredhenien kontraktore.

- 10.4 Kjo kontratë zgjidhet në mënyrë të njëanshme kur subjekti për siperfaqen që ka kryer veprimtarinë nuk e ka rehabilituar në zbatim të planit të rehabilitimit të miratuar, në rast se një detyrim i tillë është parashikuar në miratimin e Keshilliit te Bashkise.
- 10.5 Nese rezulton ndonjeri nga rastet e parashikuara ne kete nen qe perben shkak per zgjidhjen e kontrates, pala e demtuar i dergon nje njoftim me shkrim pales tjetere duke i evituar shkeljen e kushteve te kontrates dhe lenien e nje **afati 7 ditor** per plotesimin apo permbushjen e kushteve kontraktore dhe se ne rast te kundert, pra ne rast mospermbushje pas kalimit te ketij afati kontrata konsiderohet e zgjidhur. Ky njoftim ka vleren e kushtit zgjidhes te kontrates pa qene e nevojshme qe zgjidhja te shpallet nga gjykata apo organ tjetere.

Neni 11 **Dispozita të fundit**

- 11.1 Për çështjet që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme në rast se do lindin mosmarrëveshje midis palëve, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë kontratën e qirasë.
- 11.2 Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptim të palëve në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkoder .
- 11.3 Çdo korrigjim i kontratës, para dhe pas nënshkrimit të saj, e bën atë të pavlefshme.

Kjo kontratë qiraje u formulua në tre kopje origjinale, bashkelidhur se ciles jane plani i reahabilitimit, Urdheri qe ka miratuar lidhjen e kontrates, leje e mjedisit, leje e ndertimit, aktin e regjistrimit prane QKB-se, Leja/licensa perkatese, harten topografike me koordinatat e siperfaqes objekt perdorimi ne formatin PDF dhe ne format elektronik ne shkallen 1:10000 ku te jene evidentuar elementet kryesore, nga keto kopje një e merr Qiramarrësi, Dy Bashkia Vau Dejes .

QIRADHENESI
BASHKIA VAU DEJES
Me autorizim
ZV/KRYETARI

KRISTIAN SHKRELI



QIRAMARRESI
ALBTELECOM

Përfaqesues me prokurë

UFUK ÇELIK

Ufuk Çelik
Henri Tabaku

HENRI TABAKU

Henri Tabaku

